



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ___ / 2026

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 128, DATË 11.5.2009 “PËR TREGTINË ELEKTRONIKE” I NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 128, datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike”, i ndryshuar bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1, ndryshon si më poshtë:

“Neni 1

Objekti dhe qëllimi

- 1. Objekti i këtij ligji është vendosja e rregullave për kryerjen e veprimeve tregtare në rrugë elektronike, nëpërmjet shërbimeve të ofruara nga shoqëria e informacionit, për mbrojtjen e personave pjesëmarrës, mbrojtjen ligjore të konfidencialitetit të konsumatorëve apo e të dhënave konfidenciale të pjesëmarrësve në të, si dhe për të siguruar lëvizjen e lirë të shërbimeve të informacionit.*
- 2. Ky ligj vendos gjithashtu, rregulla për parandalimin e bllokimit gjeografik të pajustificuar dhe formave të tjera të diskriminimit për shkak të shtetësisë, vendbanimit të klientit ose vendit të*

¹ Ky ligj është përafuar plotësisht me: Rregulloren (BE) 2018/302 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 28 shkurt 2018 mbi adresimin e bllokimit gjeografik të pajustificuar dhe formave të tjera të diskriminimit bazuar në shtetësinë e konsumatorëve, vendbanimin ose vendin e themelimit të klientëve brenda tregut të brendshëm, si dhe për ndryshimin e Rregulloreve (KE) Nr. 2006/2004 dhe (BE) 2017/2394 dhe Direktivës 2009/22/KE (Tekst me rëndësi për ZEE-në) Numri CELEX: 32018R0302, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 60/1, datë 2.3.2018, faqe 1–15.

vendosjes së klientëve, të harmonizuar me rregullat e Bashkimit European.”

Neni 2

Në fund të nenit 3, shtohen gërmat “k’ deri në “y”, me këtë përmbajtje:

- k) “Shërbime të ofruara elektronikisht” janë shërbimet që ofrohen nëpërmjet internetit ose një rrjeti elektronik, natyra e të cilave e bën ofrimin e tyre thelbësisht të automatizuar, me ndërhyrje minimale njerëzore, dhe të pamundur pa përdorimin e teknologjisë së informacionit.*
- l) “Tarifë shkëmbimi” është tarifa e paguar për çdo transaksion, ndërmjet emetuesit dhe pranuesit të përfshirë në një transaksion pagese të bazuar në kartë, sipas legjislacionit për tarifën e shkëmbimit për transaksionet e pagesave të bazuara në kartë.*
- ll) “Instrument pagese i bazuar në kartë” është instrumenti i pagesës i bazuar në kartë, sipas përkufizimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi për shërbimet e pagesave.*
- m) “Markë pagese” është marka e pagesës, sipas përkufizimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi për shërbimet e pagesave.*
- n) “Transaksion pagese” është transaksioni i pagesës, sipas përkufizimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi për shërbimet e pagesave.*
- nj) “Shërbim pagese” është shërbimi i pagesës, sipas përkufizimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi për shërbimet e pagesave.*
- o) “Ofrues i shërbimeve të pagesave” është ofruesi i shërbimeve të pagesave, sipas përkufizimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi për shërbimet e pagesave.*
- p) “Llogari pagese” është llogaria e pagesës, sipas përkufizimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi për shërbimet e pagesave.*
- q) “Instrument pagese” është instrumenti i pagesës, sipas përkufizimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi për shërbimet e pagesave.*
- r) “Debitim direkt” është debitimi direkt, sipas përkufizimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi për shërbimet e pagesave.*
- rr) “Transfertë krediti” është transferta e kredisë, sipas përkufizimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi për shërbimet e pagesave.*
- s) “Konsumator” është çdo person fizik që vepron për qëllime jashtë veprimtarisë së tij tregtare, biznesit, zanatit ose profesionit.*
- sh) “Klient” është konsumatori që ka shtetësinë e një shteti anëtar ose vendbanimin në një shtet anëtar, ose ndërmarrja që ka vendin e vendosjes në një shtet anëtar, dhe që merr një shërbim ose blen një mall, ose synon ta bëjë këtë, brenda Bashkimit European, vetëm për qëllime të përdorimit fundor.*
- t) “Kushte të përgjithshme aksesit” janë të gjitha kushtet, termat dhe informacionet e tjera, përfshirë çmimet neto të shitjes, që rregullojnë aksesin e klientëve në mallrat ose shërbimet e ofruara për shitje nga tregtari, të cilat përcaktohen, zbatohen dhe vihen në dispozicion të publikut të gjerë nga tregtari ose në emër të tij, dhe që zbatohen në mungesë të një marrëveshjeje të negociuar individualisht ndërmjet tregtarit dhe klientit.*
- th) “Mallra” janë çdo send i luajtshëm trupor, me përjashtim të sendeve të shitura nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm ose në ndonjë mënyrë tjetër të autorizuar prej ligjit.*

- u) “Ndërfaqe online” është çdo program kompjuterik (softuer), përfshirë një faqe interneti ose një pjesë të saj dhe aplikacionet, përfshirë aplikacionet celulare, që operohet nga tregtari ose në emër të tij dhe që shërben për t’u mundësuar klientëve akses në mallrat ose shërbimet e tregtarit, me qëllim angazhimin e tyre në një transaksion në lidhje me këto mallra ose shërbime.
- v) “Shërbim” është çdo veprimtari ekonomike e pavarur, e ofruar zakonisht kundrejt shpërblimit, sipas përcaktimeve në nenin 57 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian.
- x) “Tregtar” është çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, që vepron, përfshirë edhe nëpërmjet një personi tjetër që vepron në emër ose për llogari të tij, për qëllime që lidhen me veprimtarinë e tij tregtare, biznesin, zanatin ose profesionin.
- xh) “Gjeobllokim” nënkupton bllokimin objektivisht të pajustificuar gjeografik, në kuptim të këtij ligji, referuar edhe si “geo-blocking”.
- y) “Shtet anëtar” nënkupton çdo shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose shtet kontraktues të Zonës Ekonomike Evropiane.

Neni 3

Në fund të gërmes “d”, të nenit 12, shtohet togfjalëshi, “, përveç sa parashikohet në Kreun V, të këtij ligji lidhur me gjeobllokimin”.

Neni 4

Kreu V, ndryshohet si më poshtë:

“KREU V

PARANDALIMI I GJEOBLLOKIMIT TË PAJUSTIFIKUAR

Neni 15

Zabtimi i parandalimit të gjeobllokimit të pajustificuar

1. Ky kre zbatohet për parandalimin e gjeobllokimit të pajustificuar dhe forma të tjera diskriminimi, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, për shkak të shtetësisë, vendbanimit ose vendit të vendosjes të klientit, përfshirë qartësimin e mëtejshëm të situatave të caktuara në të cilat trajtimi i ndryshëm nuk mund të justifikohet sipas legjislacionit në fuqi për ofrimin e shërbimeve.
2. Ky kre nuk zbatohet për situata thjesht të brendshme, në të cilat të gjitha elementet përkatëse të transaksionit kufizohen brenda territorit shqiptar.
3. Ky kre nuk zbatohet për aktivitetet e përjashtuara nga fusha e zbatimit të legjislacionit në fuqi për shërbimet.
4. Ky kre zbatohet pa cenuar legjislacionin në fuqi për taksat dhe tatimet.
5. Ky kre nuk prek legjislacionin në fuqi për të drejtat e autorit.
6. Ky kre nuk cenon legjislacionin në fushën e së drejtës ndërkombëtare private në lidhje me juridiksionin gjyqësor në çështjet civile. Zbatimi i këtij kreu nuk interpretohet sikur nënkupton se tregtari i drejton veprimtarinë e tij drejt shtetit anëtar të vendqendrimit të zakonshëm ose të vendbanimit të konsumatorit, në kuptim të legjislacionit në fuqi për të drejtën ndërkombëtare private. Në veçanti, kur tregtari, në përputhje me nenet 16,17, 18 dhe 19 të këtij kreu, nuk bllokon ose kufizon aksesin e konsumatorëve në një ndërfaqe online, nuk i

ridrejton ata, për shkak të shtetësisë ose vendbanimit të tyre, drejt një versioni tjetër të ndërfaqes online nga ai në të cilin kanë kërkuar fillimisht të hyjnë, nuk zbaton kushte të ndryshme të përgjithshme aksesit për shitjen e mallrave ose ofrimin e shërbimeve në rastet e parashikuara në këtë kre, ose pranon në mënyrë jodiskriminuese instrumente pagese të lëshuara në një shtet tjetër anëtar, ai nuk konsiderohet, vetëm për këto arsye, se i drejton veprimtarinë e tij drejt shtetit anëtar ku konsumatori ka vendqendrimin e zakonshëm ose vendbanimin. Po kështu, tregtari nuk konsiderohet, vetëm për këto arsye, se i drejton veprimtarinë e tij drejt shtetit anëtar të vendqendrimit të zakonshëm ose të vendbanimit të konsumatorit edhe kur, pas lidhjes së kontratës që rrjedh nga zbatimi i këtij kreu, i jep konsumatorit informacion dhe asistencë.

7. Parashikimet për mosdiskriminimin në legjislacionin në fuqi për shërbimet zbatohen për aq sa ky kre nuk parashikon dispozita më të posaçme.”

Neni 16

Aksesi në ndërfaqet online

1. Ndalohet që tregtari, nëpërmjet masave teknologjike ose në çdo mënyrë tjetër, të bllokojë ose të kufizojë aksesin e klientit në ndërfaqen e tij online, për shkak të shtetësisë, vendbanimit ose vendit të vendosjes të klientit.
2. Ndalohet që tregtari, për shkak të shtetësisë, vendbanimit ose vendit të themelimit të klientit, ta ridrejtojë atë drejt një versioni të ndryshëm të ndërfaqes së tij online nga ai në të cilin klienti ka kërkuar fillimisht të hyjë, për shkak të paraqitjes, gjuhës së përdorur ose karakteristikave të tjera që e bëjnë këtë version të posaçëm për klientë me një shtetësi, vendbanim ose vend vendosje të caktuar, përveç rastit kur klienti ka dhënë pëlqimin e tij të shprehur për këtë ridrejtim.

Në rast ridrejtimi me pëlqimin e shprehur të klientit, versioni i ndërfaqes online në të cilin klienti ka kërkuar fillimisht të hyjë mbetet lehtësisht i aksesueshëm për të.

3. Ndalimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen kur bllokimi ose kufizimi i aksesit, apo ridrejtimi, është i nevojshëm për të siguruar pajtueshmërinë me një kërkesë ligjore të parashikuar në legjislacionin në fuqi, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Europian, që zbatohet për veprimtarinë e tregtarit.

Në këto raste tregtari i jep klientit një shpjegim të qartë dhe të posaçëm për arsyet që e bëjnë të nevojshëm bllokimin ose kufizimin e aksesit, apo ridrejtimin. Shpjegimi jepet në gjuhën e ndërfaqes online në të cilën klienti ka kërkuar fillimisht të hyjë.”

Neni 17

Aksesi në mallra ose shërbime

1. Ndalohet tregtari të zbatojë kushte të ndryshme të përgjithshme aksesit për mallra ose shërbime, për shkak të shtetësisë, vendbanimit ose vendit të vendosjes të klientit, kur klienti synon:

a) të blejë mallra nga tregtari, kur këto mallra dorëzohen në një vendndodhje në një shtet anëtar, për të cilin tregtari ofron dorëzim sipas kushteve të përgjithshme të aksesit, ose

merren në dorëzim në një vend të rënë dakord ndërmjet tregtarit dhe klientit, në një shtet anëtar ku tregtari e ofron një mundësi të tillë sipas këtyre kushteve;

- b) të përfitojë nga tregtari shërbime të ofruara elektronikisht, me përjashtim të shërbimeve, tipari kryesor i të cilave është dhënia e aksesit në vepra të mbrojtura nga e drejta e autorit ose në objekte të tjera të mbrojtura, si dhe përdorimi i tyre, përfshirë shitjen e veprave të tilla ose të objekteve të tjera të mbrojtura në formë jomateriale;*
 - c) të përfitojë nga tregtari shërbime, të ndryshme nga shërbimet e ofruara elektronikisht, në një vendndodhje fizike brenda territorit të një shteti anëtar ku tregtari ushtron veprimtarinë e tij.*
- 2. Ndalimi i parashikuar në pikën 1, të këtij neni nuk e pengon tregtarin të ofrojë kushte të ndryshme të përgjithshme aksesit, përfshirë çmimet neto të shitjes, të cilat ndryshojnë ndërmjet shteteve anëtare ose brenda të njëjtit shtet anëtar, për sa kohë që këto u ofrohen klientëve në një territor të caktuar ose grupeve të caktuara të klientëve mbi bazë jodiskriminuese.*
 - 3. Respektimi i ndalimit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni nuk nënkupton, në vetvete, se tregtari është i detyruar të respektojë kërkesat ligjore jokontraktore kombëtare që lidhen me mallrat ose shërbimet përkatëse të shtetit anëtar të klientit, apo të informojë klientin për këto kërkesa.*
 - 4. Ndalimi i parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni nuk zbatohet ndaj tregtarëve që përjashtohen nga TVSH-ja në bazë të legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.*
 - 5. Ndalimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohet për aq sa një dispozitë e posaçme e parashikuar në legjislacionin në fuqi në përputhje me të drejtën e Bashkimit European, e pengon tregtarin të shesë mallrat ose të ofrojë shërbimet për klientë të caktuar ose për klientë në territore të caktuara.”*

Neni 18

Aksesi në libra

Për shitjen e librave, ndalimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 17 nuk e pengon tregtarin të zbatojë çmime të ndryshme për klientë në territore të caktuara, kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni në fuqi në përputhje me të drejtën e Bashkimit European.”

Neni 19

Mosdiskriminimi për arsye lidhur me pagesat

- 1. Ndalohet tregtari, brenda gamës së mjeteve të pagesës që ai pranon, të zbatojë kushte të ndryshme për një transaksion pagese, për shkak të shtetësisë, vendbanimit ose vendit të vendosjes të klientit, vendndodhjes së llogarisë së pagesës, vendit të vendosjes të ofruesit të shërbimeve të pagesave ose vendit të lëshimit të instrumentit të pagesës brenda Bashkimit European, kur plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:*
 - a) transaksioni i pagesës kryhet në mënyrë elektronike, përmes transfertës së kreditit, debitimit direkt ose përdorimit të një instrumenti pagese të bazuar në kartë, brenda së njëjtës markë pagese dhe së njëjtës kategori;*

- b) përmbushen kërkesat e autentifikimit, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e pagesave;
- c) transaksioni i pagesës kryhet në një monedhë të pranuar nga tregtari.
2. Kur kjo justifikohet nga arsye objektive, ndalimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk e pengon tregtarin të pezullojë dorëzimin e mallrave ose ofrimin e shërbimit deri në marrjen e konfirmimit se transaksioni i pagesës është inicuar rregullisht.
3. Ndalimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk e pengon tregtarin të kërkojë tarifa shtesë për përdorimin e një instrumenti pagese të bazuar në kartë, për të cilin tarifat e shkëmbimit nuk rregullohen nga legjislacioni në fuqi për tarifat e shkëmbimit për transaksionet e pagesave të bazuara në kartë, si dhe për ato shërbime pagese për të cilat nuk zbatohet legjislacioni në fuqi për kërkesat teknike dhe tregtare për transfertat e kreditit dhe debitimet direkte në euro, përveç rasteve kur legjislacioni në fuqi për shërbimet e pagesave parashikon ndalimin ose kufizimin e së drejtës për të kërkuar tarifa për përdorimin e instrumenteve të pagesës. Tarifa të tilla nuk mund të tejkalojnë kostot direkte të përballuara nga tregtari për përdorimin e instrumentit të pagesës.”

Neni 20

Marrëveshjet që kufizojnë shitjet pasive

1. Pa cënuar zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës, ky kre nuk zbatohet ndaj marrëveshjeve që kufizojnë shitjet aktive dhe/ose pasive, sipas legjislacionit në fuqi për përjashtimin në bllok të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara, për aq sa këto marrëveshje kanë të bëjnë me transaksione që nuk përfshihen në ndalimet e parashikuara në nenet 16, 17, 18 dhe 19 të këtij ligji.
2. Çdo parashikim kontraktor që, në lidhje me shitjet pasive, i imponon tregtarit detyrimin për të vepruar në kundërshtim me ndalimet e parashikuara në nenet 16, 17, 18 dhe 19 të këtij ligji, është automatikisht i pavlefshëm.

Neni 5

Pika 1, e Nenit 21, ndryshon si vijon:

- “ 1. Për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve, të përcaktuara në këtë ligj ngarkohen autoritetet kompetente të përcaktuara sipas ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, sipas fushave të tyre të kompetencës. Përgjegjësia kryesore dhe koordinuese mbetet me autoritetin kompetent të mbrojtjes së konsumatorëve.”

Neni 6

Në nenin 21/1, shtohet pika 3, si vijon:

- “3. Për ndihmën praktike ndaj konsumatorëve në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit, që lind nga zbatimi i dispozitave të Kreut V, të këtij ligji, ngarkohen pikat e kontaktit ZAM, sipas parashikimeve të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve.”

Neni 7

Në nenin 22, pika 1, gërma “d” ndryshohet si vijon:

“d) për mosrespektim të neneve 15-19 për gjeobllokimin e pajustificuar në lidhje me aksesin e ndërfaqeve online, aksesin në mallra dhe shërbime dhe mosdiskriminim në lidhje me pagesat.”

Neni 8

Në fund të nenit 25/1, shtohet paragrafi sa vijon:

“Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, gërmat “k” deri në “xh” të nenit 3 të këtij ligji dhe Kreu V i këtij ligji shfuqizohen. Dispozitat për autoritetet kompetente dhe sanksionet administrative lidhur me parashikimet materiale në Kreun V të këtij ligji mbeten në fuqi.”

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI